

INTERIM ADMINISTRATION OF KOSOVO
ADMINISTRATA E PËRKOHËSHME E KOSOVËS
PRIVREMENA ADMINISTRACIJA KOSOVA

C.nr.499/2007

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË, si civile e shkallës së parë e
bërbër nga gjyqtari Ramë Hyseni – si kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve porot
Shaban Kelmendi dhe Zymer Azemi – si anëtar të trupit gjykues, në qështjen juridike të
padiçësit nga Mitrovica Rr. të cilin e përfaqëson
Avokat nga Mitrovica – sipas autorizimit me shkrim, kundër të paditues
Komuna e Mitrovicës të cilën e përfaqëson Avokat Publik Komunal për
shkakë të Vërtetimit të pronësis, vlera e kontestit 750 € pasë mbajtjes të seancës së
shqyrtimit kryesor me datë 23.11.2007 muarë këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadija e padiçësit nga dhe
VËRTETOHET se i njëjti është pronar i paluajtëshmëris e cila evidentohet si
ng.kat.nr. me kultur ndërtesë, në sipërfaqe prej 0.00,48 ha, në vendin e quajtur
sipas fl.pos.nr. të ZK Mitrovicë, e cila evidentohet në emër të të paditues
dhe obligohet e paditura që padiçësit të ia pranoi këtë të drejtë dhe
të lejoj që padiçësi në bazë të këtij aktgjykimi të regjistrohet si pronar në librat përkatëse
pronësore pranë në në afat prej 15 ditësh,
nënkëcënim të përmbarimit të dhunëshem.

Obligohet e paditura që padiçësit të ia kompenzoi shpenzimet e procedures në
shumë prej 549,20 € në afat prej 15 ditësh, nënkëcënim të përmbarimit të dhunëshem.

A r s y e t i m

Padiçësi në padi dhe përmesë të autorizuarit gjatë shqyrtimeve të mbajtura, si dhe
në precizimin e kërkesëpadiis në shqyrtimin kryesor thekësoi, se padiçësit nga ana e të
paditues me aktvendimin nr. të datës 25.12.1992 i është dhënë në shfrytëzim
banesa, e cila gjindet në në ishë Rr. nr. në bazë të të ciles kontrat

paditësi me ndermarrjen e atëherëshme për shërbime banesore në Mitrovicë kanë lidhur kontrat mbi blerjen e banesës nr.51 dt. 30.12.1992. Në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji mbi Banimin me të cilin është lejuar blerja e banesave, paditësi në mënyrë të rregulltë dhe ligjore, e ka blerë banesën në fjalë në bazë të kontrates mbi blerjen e banesës të vrëtetuar te Gjykata Komunale në Mitrovicë VR.II. nr. të dt. 18.02.1994. Tani me rastin e tentimit të paditësit që ta tjetërsoi personit të tretë, i njejtë ka konstatuar se kjo banesë gjindet në ng.kat.nr. në vendin e quajtur me kultur ndërtesë, në sipërfaqe të tërësishme prej 0.00,48ha të evidentuar në fl.pos.nr. të ZK , në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadin ta aprovonë në tërësi si të bazuar me precizimin e dhenë në shqyrtimin kryesor, shpenzimet e procedurës i kërkonë.

Përfaqësuesi i të paditues në përgjegje nga padia deklaroi, se konsideronë se kjo qështje juridike nuk hynë në kompetent gjyqësore, për arsye se raporti përkatës juridik është zgjedhur me kontrat dhe qështja në fjalë duhet të procedohet në bazë të kontrates, i ka propozuar gjykatës që të vendos në bazë të rezultatit të provave, duke thekësuar se edhe me tej e kontestonë kërkesëpadin e paditësit, shpenzimet e procedurës nuk i kërkonë.

Gjykata i nxorri provat e propozuara nga palët, dhe pasi i vlerësoi të njejtat në kuptim të nenit 8. të LPK-së vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit dhe e aprovoi kërkesëpadin e paditësit si të bazuar për këto arsye:

Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezis e datës 16.10.2007 gjykata e vërtetoi faktin, se në bazë të dokumentacionit me të cilin posedonë për momentin e në ngastra kontestuese me kultur ndërtesë në sipërfaqe prej 0.00,48 ha, në vendin e quajtur evidentohet në emër të pasuris shoqërore – sipas fl.pos.nr. të Mitrovicë. Gjithënjë sipas të njejtit ekspert në munges të dokumentacionit arkivol nuk ka mundësi që ta japë historiatin e ngastres Nga aktvendimi 08 nr. i datës 25.12.1992 gjykata e vërtetoi faktin, se e paditura ia ka ndarë në shfrytëzim, në bazë të çirësë banesën një dhomëshe, e cila gjindet në Mitrovicë në ishë Rr. “ nr. Në bazë të kontrates mbi blerjen e banesës VR.II nr. të dt. 18.02.1994 gjykata e vërtetoi faktin, se paditësi nga e paditura e ka blerë banesën e cila është objekt i këtij kontesti. Në dispoziten e nenit 20 al. 2. të Ligjit mbi Mardhaniet Themelore Pronësore Juridike parashifetë “ e drejta e pronësis fitohet me vendimin e organit shtetëror, në mënyrën dhe kushtet e parapara me ligj”, duke komentuar këtë dispozit ligjore rrjedhë, se paditësi ka fituar pronësin në paluajtëshmërin kontestuese, në bazë të vendimit të organit shtetëror dhe kontrates mbi blerjen e banesës e cila u cekë më lartë, e e vërtetuar te gjykata kompetente.

Nga të cekurat më lartë provat e thekësuar dhe duke u mbështetur në dispoziten e nenit 20. al. 2. të Ligjit mbi Mardhaniet Themelore Pronësore Juridike u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e pruri konform dispozitave të nenit 154 al. 1. të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe e obligoi të paditues që

paditësit të ia kompenzoi shpenzimet e procedurës në lartësi prej 594,20 €, e nga këto shumen prej 78 € në emër të përpilimit të padis, 42 € në emër të taksës për padi dhe vendim, në emër të tri përfaqësimeve shumen prej nga 101,40 € dhe në emër të ekspertizës shumen prej 125 €.

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË
C.nr. 499/2007 me datë 23.11.2007.

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Ramë Hyseni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë e përmesë kësaj gjykate.

Saktësin e përshkrimit e vërtetonë: